- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkritazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojnë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimin të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimin përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimin do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimin nga Menaxheri i Projektit dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimin dhe të cilat kanë mbetur të parealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimin. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

SHKELJA E KONTRATËS DHE SHKËPUTJA

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumatat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundojë vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të sigurojë vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplodimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktoar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësisë të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri Projektues do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimin e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetojë këtë. Kontraktuesi do të sigurojë vend punimin dhe do të ndërpres punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo që palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuhët në përdorim zyrtarë - shqipe
Siguria e ekzekutimit	10.1	Sigurimi i ekzekutimit të kontratës është min 10 % e vlerës së kontratës së nënshkruar nga data e nënshkrimit të kontratës me validitet - deri në një periudhë prej 30 ditësh pas kompleimit të kontratës, ose deri me datë 07.01.2025. nga një Bankë e licencuar nga Banka Qendrore e Kosovës, apo kompani e sigurimeve e licensuar nga BQK.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Për humbje ose dëmtim të Punëve, Impianteve dhe Materialeve <i>[shëno shumat]</i> ; (b) humbje ose dëmtim i Pajisjeve <i>[shëno shumat]</i> ; (c) humbje ose dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën <i>[shëno shumat]</i> ; (d) dëmtim personal ose vdekje: (i) të punëtorëve të Kontraktuesit: <i>[shëno shumat]</i> (ii) të personave të tjerë: <i>[shëno shumat]</i>
Programi	12.1	Planin për Menaxhimin e Kontratës. Kontraktuesi do ta dorëzojë për aprovim Programin për Punët brenda <u>2 ditëve</u> nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 2 ditë nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë : Dy ditë pas nënshkrimit të kontratës (Varësisht nga kushtet atmosferike, në konsultim me menaxherin e projektit)
	17.2	Përfundimi i punëve bëhet sipas planit të menaxhimit të kontratës - 60 ditë kalendarike, ose deri me datë 07.12.2024.
Dëmet e likuiduara	19.1	Norma e dëmeve të likuiduara është 0.25 % e Çmimit final të Kontratës në ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për tërë kontratën është 10% të çmimit final të kontratës
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahet nga ana e kontraktuesit

Inspektimi dhe testimi	22.1	Inspektimi i cilësisë dhe sasisë së punëve do të bëhet në momentin e dorëzimit që janë lëndë e kësaj kontrate, nga Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve – i emëruar nga ana e Zyrtarit Kryesor Administrativ të Autoritetit Kontraktues. Asnjë furnizim i mallit respektivisht asnjë ekzekutim i punëve-shërbimeve nuk do të konsiderohet valid dhe i pranuar, deri sa nuk konfirmohet cilësia dhe sasia, nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit të punëve - të Autoritetit Kontraktues. Menagjer i projektit nga AK është: Ylli Qafleshi Menagjer mbikqyres i kontrates nga AK është: Bean Haxhiasani Menagjer i projektit nga OE është: Ismail Ahmeti
Pagesa		Sipas Raportit të prezantuar – dorëzuar nga Menaxheri i Projektit- situacioneve të aprovuara nga ana e Organit mbikëqyrës- menaxherit të projektit, pagesa do të kryhet në afate sa më të shkurtë kohor dhe jo më gjatë se 30 ditë nga data e pranimit dhe evidentimit të faturës, kurse pjesa tjetër e kontratës do të realizohet pas përfundimit të punimeve të përcjellura me raport nga ana e menaxherit të kontrates dhe raportit nga ana e komisionit të pranimit teknik të projektit.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: Nuk ka pagesë paraprake.
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: E vlerës së kontratës.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë [shëno numrin] ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është : 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm. Dokumenti Polisa e sigurimit të kualiteti të lëshuar nga një Bank apo kompani e sigurimeve e licensuar nga Banka Qendrore e Kosovës 10 % vleren e përgjithëshme të kontratës, me afat validiteti për prej 12 muaj nga data e pranimit teknik të përkohshëm.
siguria e punëtorëve		Operatori ekonomik që ka nënshkruar kontratën mbanë të gjithë përgjegjësinë për vdekjen, lëndimet, sëmundjet dhe çdo dëm tjetër të punëtorëve gjatë zbatimit të projektit, si dhe që Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asgjë që ndodh gjatë zbatimit të projektit.
Sigurinë e banorëve, këmbësorëve dhe automjeteve		Punimet e ndërtimit do të kryhen në mënyrë që të garantojnë sigurinë e banorëve, këmbësorëve dhe automjeteve në afërsi. Materialet e mbeturinave do të asgjësohen në mënyrën e duhur në përputhje me rregulloret standardet, si dhe që Autoriteti Kontraktues nuk do të jetë përgjegjës për asgjë që ndodh gjatë zbatimit të projektit.
Pagesa pas shkëputjes	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit

së kontratës		Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, në pajtim me ligjin në Kosovë. b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Kubezimi i rrugeve dhe Ura ne Zym dhe Qollopek

1. KUBËZIM I RRUGËS te Sama - Aksi 1

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, nëgjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PREGADITORE				
1.1	Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	320.00	0.10 €	32.00 €
1.2	Identifikimi instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qellim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, Në këtë pozicion përfshihet edhe plani I situacionit të rrjetit ekzistues me qellim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubëzave në rruget lokale të Fshatit. Llog m2	m2	320.00	0.20 €	64.00 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m'	m2	320.00	0.30 €	96.00 €
Gjithsej: Pos 1					192.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE				
Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashesi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Germimi me makineri (70%)	m3	100.80	1.00 €	100.80 €
2.2	Germimi me dorë (20%)	m3	28.80	1.00 €	28.80 €
2.3	Germimi me çekan (10%)	m3	14.40	1.00 €	14.40 €
2.4	Planifikimi dhe punimi i bazamentit të rruges , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	320.00	0.10 €	32.00 €

Gjithsej: Pos 2					176.00 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPON)				
Furnizimi, transporti, shtrirja nivelizimi ngjeshja dhe punimi i shtresës së nën bazës së rrugës , nga materiali guror ,Fraksion (0 deri 63) mm me trashësi të shtresës t=20 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=650 kg/cm2 . Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve. Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-63 mm t=20cm	m3	64.00	7.00 €	448.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazes dhe punimi i bazës së rruges , me materialin guror nga gurit të thyer fraksion(0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	32.00	6.50 €	208.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.3	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	16.00	6.50 €	104.00 €
Gjithsej: Pos 3					760.00 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE				
Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni I klasit C 30/37 , d-8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetenc e percaktuar nga Investitori.Në çmim të parashifet edhe Furnizimi,transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne sipërfaqen e cila eshte e kubezuar. Vërejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugët përgjatë perimetri të rrugës.					
4.1	Furnizimi , Transporti dhe montimi I kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugave me rërë(filer)	m2	320.00	14.00 €	4,480.00 €
4.2	Furnizimi dhe montimi i skajoreve nga betoni C-30/37 dim.(18x24x100) cm, me baze betoni llogaritur me te gjitha punimet e tjera te nevojshme.	m'	180.00	5.00 €	900.00 €
Gjithsej: Pos 4					5,380.00 €

1. REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGES AKSI I

1	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej: Pos 1	192.00 €
---	-------------------	-----------------	----------

2	PUNIMET TOKËSORE	Gjithsej: Pos 2	176.00 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	Gjithsej: Pos 3	760.00 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME	Gjithsej: Pos 4	5,380.00 €
		TOTALI:	6,508.00 €

2. KUBËZIM I RRUGËS te Xhamia - Aksi 2

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Të gjitha punët në përputhje me normat teknike dhe standardet Europiane dhe Eurokodit , Kompania punë kryese është përgjegjëse për ti marrë masat mbrojtëse dhe të siguroj punishten me mjetet sinjalizuese para fillimit të punët, nëgjithë zonën ku do të zhvilloj aktivitet e saj. Çdo dëmtim të instalimeve nëntoksore të qytetarve është e obliguar ti kthejë në gjendje të mëparshme me kosto të vetën financiare					
1	PUNËT PREGADITORE				
1.1	Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet te infrastruktura rrugore sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m2	m2	280.00	0.10 €	28.00 €
1.2	Identifikimi instalimeve nëntoksor dhe mbitoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qellim të evitimin parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, Në këtë pozicion përfshihet edhe plani I situacionit të rrjetit ekzistues me qellim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin dhe kubezimin e kubëzave në rruget lokale të Fshatit. Llog m2	m2	280.00	0.20 €	56.00 €
1.3	Shënimi dhe inçizimet gjeodezike në zonat dhe segmentet rrugore ku do të punohet sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m'	m2	280.00	0.30 €	84.00 €
Gjithsej: Pos 1					168.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE				
Gërryerja ,gërmimi dhe largimi i dheut të kat III -V Me makina ndertimore në vendet e projektuara për nivelizimin dhe zgjerimin dhe rregullimin e rrugës lokale me trashesi t = 20 deri ne 40 cm . Në këtë pozicion përfshihet edhe nivelizimi terenit me ramjet e duhura duke përfshi edhe elementet tjera përcjellëse të përcaktuar në projekt sipas kushteve teknike dhe përgjithshme , si dhe detaleve teknike . Largimi i dheut te germuar ne deponin te cilen e cakton investitori Llog m3 me të gjitha shpenzimet.					
2.1	Planifikimi,grryerja dhe punimi i bazamentit të rruges , para se të vendosen shtresat e tamponit .Llog me të gjitha shpenzimet	m2	280.00	0.20 €	56.00 €

Gjithsej: Pos 2					56.00 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)				
Furnizimi, transporti, shtrirja,nivelizimi i bazes dhe punimi i bazës së rruges , me materiali guror nga gurit të thyer fraksion(0-32) mm, me trashësi të shtresës t=10 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues.Materiali i përdorur duhet te jete i paisur me ateste paraprake ,dhe ate sipas normave dhe standardeve.Ngjeshja deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 .					
Vrejtje : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompania punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin e modulit të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.1	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-31.5 mm , t= 10 cm	m3	28.00	6.50 €	182.00 €
Furnizimi, transporti, shtrirja dhe punimi i shtresës rrafshuese me rere te imet nga gurit të thyer fraksion 0-4mm, me trashësi të shtresës t=5 cm si dhe ngjeshja e tij me cilindër vibrues deri sa të fitohet moduli i ngjeshjes Mv=500 kg/cm2 . Sqarim : Pas përfundimit të kësaj shtrese kompani punëkryese është e obliguar ta shqyrtoj testin moduli të ngjeshjes dhe ta prezentoj tek menaxheri kontratës.					
3.2	Furnizimi dhe punimi i shtresës rrugëve me gurë të thyer fraksion 0-4 mm t= 5 cm	m3	14.00	6.50 €	91.00 €
Gjithsej: Pos 3					273.00 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME ELEMENTE BETONO-MONTUESE				
Furnizimi, transporti dhe montimi i elementeve nga betoni, llogaritur te gjitha punimet e nevojshme, nga betoni I klasis C 30/37 , d-8cm forma e gjeometris së kubëzave ,kompetenc e percaktuar nga Investitori.Në çmim të përshifet edhe Furnizimi,transporti dhe shperndarja e reres (filerit) per mbushjen e fugave ne siperfaqen e cila eshte e kubezuar. Vërejtje : Ruga e cila kubëzohet në tërësi të sipërfaqes zgjeruese prej muri në murë kur nuk ka gurë skajor përforcimi i kubëzave bëhet me beton në tërë gjatësin e rrugës të shprehur në m2 në dy anët e rrugët përgjatë perimetri të rrugës.					
4.1	Furnizimi , Transporti dhe montimi I kubëzave duke llogaritur në çmim edhe mbushjen e fugave me rërë(filer)	m2	280.00	14.00 €	3,920.00 €
Gjithsej: Pos 4					3,920.00 €

2. REKAPITULIMI - KUBËZIMI RRUGES AKSI 2

1	PUNËT PREGADITORE	Gjithsej: Pos 1	168.00 €
2	PUNIMET TOKËSORE	Gjithsej: Pos 2	56.00 €
3	PUNIMET E MBUSHJES (TAMPONI)	Gjithsej: Pos 3	273.00 €
4	PUNIMET E MBISTRUKTURËS RRUGËS ME	Gjithsej: Pos 4	3,920.00 €
TOTALI:			4,417.00 €

REKAPITULIMI TOTAL PER FSHATIN ZYM

1	1. KUBËZIM I RRUGËS te Sama - Aksi 1	6,508.00 €
2	2. KUBËZIM I RRUGËS te Xhamia - Aksi 2	4,417.00 €
TOTALI:		10,925.00 €

1. NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TE URA NE FSHATIN QOLLOPEKË , H= 3.0m ; L=15m

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
Përveç përshkrimit të pozicioneve individuale të punimeve, çmimi përfshin kushtet e mëposhtme të përbashkëta: • në çmimin e çdo pozicioni të punimeve, materialeve, punës, veglave, skelave ndihmëse , të cilat janë të përshkruara sipas standardeve dhe normave teknike, si dhe shpenzimet e tjera; • çdo lloj pune është parapar në përputhje me normat dhe rregulloret teknike për këtë lloj pune, me të gjitha rregulloret përkatëse për sigurinë në punë dhe mbrojtjen nga fatkeqsit eventuale. Përshkrime të përgjithshme për kryerjen e të gjitha llojeve të punimeve • Të gjitha punimet janë të kushtëzuara për përdorim të punëve profesionale dhe përdorimin e materialeve cilësore, të cilat duhet të jenë në përputhje me standardet e vlefshme. Strukturat ndihmëse • Përdorimi i të gjitha llojeve të skelave, pa marrë parasysh lartësinë dhe formën, përfshihet në vlerë njësi të punës për të cilën ato janë të nevojshme, • Në çmim llogaritet çmontimin e skelës në vendin e ndërtimit. • Në çmim duhet të parashifen dhe Vendosja e tabelave dhe shenjave tjera të sinjalizimit dhe paralajmërimit. Montimi dhe punimi i gardheve dhe shiritave mbrojtës. Masa dhe llogaritja e vlerës operative Llogaritja është bërë për njësi të masës së punimeve të përfunduara, dhe sipas standardeve të vlefshme në ndërtim. Të gjitha punët dhe detyrimet tjera shtesë të cilat shfaqen gjatë ekzekutimit të punëve rregullohen apo kompenzohen sipas normave të bazuar në Ligji për Ndërtimin e Objekteve Investive dhe rregulloreve , standardeve të cilat e rregullojnë këtë fushë. Punë përgatitore dhe punët demoluese Në të gjitha pozicionet përfshihet çmimi i punës për sigurimin dhe vendosjen e etiketave /shenjave paralajmëruese, pastrimin e dhe lirin e hapësirës demoluese, si dhe ngarkimi dhe bartja e mbeturinave					
1.1	Shënimi I kantierit me shenja rreziku në zonat ku do të punohet muret mbrojtëse sipas projektit detal ,gjatë kohës sa zgjatin punimet .Llog në m'	m'	15	1.50 €	22.50 €
1.2	Identifikimi instalimeve nëntokësore dhe mbetoksorë (ujesjelles, kanalizimi, instalimet rrymes, instalimet telefonise dhe internetit), piketimi dhe regjistrimi në ditarin ndërtimor, me qëllim të evitimit parandalimin dëmtimeve eventuale mund të ndikojë në rrezikimin e personelit, Në këtë pozicion përfshihet edhe plani I situacionit të rrjetit ekzistues me qëllim që të hartohet plani i veprimit për shkyqje dhe demolim të rrjetit ekzistues pastrimin e terenit dhe pregaditjen e kushteve teknike të përgjithshme për ndërtimin e murit mbrojtës dhe punimin e trotuarit me kubëzave . Llog m2	m'	15	2.00 €	30.00 €
1.6	Inçizimi i terenit si dhe percjellja e punimeve gjeodezike gjatë ekzekutimit.Llpg.në m'.	m'	15	1.50 €	22.50 €

Totali I Pos 1 : 75.00 €

2	II PUNËT TOKËSORE				
---	--------------------------	--	--	--	--

Nr.	Përshkrimi I Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
-----	-------------------------	--------	-------	-------	-------

Punëmarrësi është i detyruar që të gjitha materialet e demoluara (sipas pos. te poshtëshënuara) ti largojë nga punishtja apo ti transportojë deri në deponinë e caktuar për deponim materiale. Materialet që i nevoiten Investitorit duhet te deponohen ne depot e parapara per grumbullim te materialit ne depot të cilën e cakton Investitori.

2.1	Pastrimi I terenit , në gjithë perimetrin ku do të zhvillohen punimet . Në qmim kalkulohet edhe bartja e materialit të demoluar deri të deponia që e cakton organi mbikqyrës . Llog m'	m'	15.00	1.00	15.00 €
2.2	Germimi i dheut (themeleve) i kategorisë së III-IV-të me makina ndërtimore dhe me vegla dore, materiali I tepërt I cili mbetet pas mbushjes deponohet me transport në deponinë të cilën e cakton investitori .Llog. Në m ³ . Ne kete4 pozicion eshte I perfshire edhe pastrimi i shtratit te lumit pergjat gjatyesise se murit.	m ³	9.00	3.00	27.00 €
2.3	Formësimi dhe ngjeshja e nenbazes se themelit te murit mbrojtës es me ngjeshmeri 30MN/m2	m ²	15.00	2.50	37.50 €
2.4	Sigurimi I gropës ndërtimore nga rrëshqitëja e dheut si dhe vendosja e shenjave të sigurisë konform normave ndërtimore në fuqi	m'	15.00	1.00	15.00 €

Totali I Pos 2 : 94.50 €

3	III PUNËT E MBUSHJES				
---	-----------------------------	--	--	--	--

Nr.	Përshkrimi I Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizim i, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit 0-63mm nen bazen e themelit me trashësi t=15cm me ngjeshmeri 50MN/m2.Llog. në m ³	m ³	2.70	7.00	18.90 €
3.2	Furnizimi dhe mbushja mbrapa murit me zhavorr te paster te lumit 63 mm ne tere Gjatësin dhe lartesine e murit.	m ³	100.00	6.50	650.00 €
3.3	Furnizimi dhe montimi I gypit te dreazhit PVC Ø100 mm prapa murit .Llog në m'.	m'	16.00	2.10	33.60 €
3.4	Furnizimi si dhe punimi I Gypi PVC Ø 70 mm për kullim e murit mbrojtës nga betoni I armuar çdo 2.0 m ,zig zak.Llog në m'	m'	10.00	1.90	19.00 €
3.5	Ngjeshja e nënbazës e themelit .Llog në m2	m ²	15.00	3.00	45.00 €

Totali I Pos 3 :					766.50 €
4	IV PUNËT E BETONIT DHE BETONARMES				
Nr.	Përshkrimi I Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
Të gjitha pozicionet e strukturave të betonit duhet të realizohen, sipas dimensioneve, dhe sipas llojit dhe klasës së betonit, dhe ate sipas dokumentacionit Teknik të projektimit, llogaritjes statike dhe detajeve të armimit. Betoni për të gjithë llojet e punimeve duhet të pregaditet, transportohet, punohet, mirembahet dhe testohet sipas parashikimeve të përcaktuara në rregullat e zbatueshme, "Rregullat për Standardet Teknike për Beton dhe Beton të Armuar (PBAB). Te gjitha panellet (kallepet) e pjeseve te dukshme te betonit te lyhen dhe te jene te kualitetit te larte ne menyre qe te permbushen edhe kriteriet e larta vizual-estetike te siperfaqeve te betonuara. Betoni për betonimin e mureve dhe shtyllave të jashtme, prapa të cilave bëhen mbushje e argjinaturat dhe shtohet hidroizolimi vertikal me shtimin e aditivëve të papërshkueshëm nga uji. Kallepet dhe platformat ,mbështetja duhet të bëhen në bazë të dimensioneve të parashikuara në mënyrë të shkathët dhe cilësore, në mënyrë që pas betonimit dhe çmontimit të punimeve të mos ndodhin as deformimi më i vogël në strukturë. Gjatë betonit strukturat konstruktive pas nderprerjeve të nevojshme të betonimeve, lidhja dhe vazhdimi duhet të pastrohen së pari, sipërfaqja duhet të jetë e ashpër, shpëlarje dhe pastaj të betonohet vazhdimi. Llogaritja e sasive të punimeve të kryera në të vërtetë nga njësitë e dhëna të masës (libri i ndërtimit). Çmimi njësi i secilit pozicion të këtyre punimeve përfshin gjithçka që është e nevojshme deri në përfundimin e së njëjtës.					
4.1	Furnizimi,transporti dhe punimi I shtreses rrafshuese ,betonimi I themeleve te murit mbrojtës nga betoni I thjeshtë C12/15 me trashesi 5 cm, ne çmim te llogaritet mirmbajtja e betonit. Punimi Sipas detalit te dhënë. Llog ne m3	m ³	1.50	65.00	97.50 €
4.2	Furnizimi,transporti dhe betonimi I themeleve 1.20m X 0.60m te murit mbrojtës nga betoni I armuar C25/30 ,Në çmim llogaritet kallupimi me drrasa, betonit duket shtuar shtesa aditivi per papershkrushmeri nga uji, duke vibruar dhe respektuar dhe mirmbajtja e betonit. Punimet te kryhen Sipas detalit te dhënë.Llog në m3	m ³	9.00	87.00	783.00 €

4.3	Furnizimi,transporti dhe betonimi I murit mbrojtës me dim sipas zgjidhjes teknike të prezentuar dhe lartësi: h=2.50 m dhe trashësi 0.35cm , nga betoni I armuar C25/30.Në çmim llogaritet kallupimi me drrasa, si dhe betonimi duke i shtur shtesa aditivi nga pa përshkrushmeria e ujit , vibruar dhe respektuar shtresën mbrojtëse Punimet të kryhen Sipas detalit të dhënë.Llog në m3.	m³	13.50	87.00	1,174.50 €
Totali I Pos 4 :					2,055.00 €
5	V PUNËT E ARMATURËS				
Nr.	Përshkrimi I Pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
5.1	Furnizimi i hekurit ndërmor, pastrimi, prerja, përpunimi dhe montimi i armatures të hekurit të brinjëzuar të klasës S 400/500 , të gjitha në përputhje me llogaritjen statike sipas detaleve teknike të armimit të përfshira në projekt. Llogaritja në kg.	kg	2,250.00	0.7	1,575.00 €
Totali I Pos 5 :					1,575.00 €

REKAPITULLIM I MURIT MBROJTËS

1	PUNET PARAPREGADITORE	75.00 €
2	II PUNËT TOKËSORE	94.50 €
3	III PUNËT E MBUSHJES	766.50 €
4	IV PUNËT E BETONIT DHE BETONARMES	2,055.00 €
5	V PUNËT E ARMATURËS	1,575.00 €
TOTALI:		4,566.00 €

2. NDËRTIMI I MURIT MBROJTËS TE URA NE FSHATIN QOLLOPEKË , H= 3.0m ; L=8m

Nr. rendor	Përshkrimi i pozicioneve	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (€)	Çmimi total me TVSH (€)
------------	--------------------------	--------	-------	-----------------	-------------------------

